



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, merr këtë:

V E N D I M  
P Ë R  
BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

1. **MIRATOHET** Vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake, nga viti 2022 në vitin 2023, përfshirë mjetet e grumbulluara në vitet paraprake, të cilat janë të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet bartja e të hyrave vetanake nga vitit 2022 në vitin 2023, në shumë prej **51,425,219.16 €**, respektivisht:

- 2.1. Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 është në vlerë prej **47,273,692.31 €**,
- 2.2. Tejkalimi i planit për të hyra vetanake në vitin 2022 është në vlerë prej **4,151,526.85 €**,

3. Mjetet e bartura nga viti 2022 do të destinohen në kategoritë për:

3.1. <i>paga dhe shtesa – 110</i> .....	100,000.00 €;
3.2. <i>mallra dhe shërbime – 130</i> .....	4,980,000.00 €;
3.3. <i>subvencione dhe transfere – 200</i> .....	250,000.00 €;
3.4. <i>investimet kapitale – 300</i> .....	46,095,219.16 €;

Gjithsej: **51,425,219.16 €**;

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ( pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-400/01-69255/23, më 03.04.2023

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina



## A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësiive dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Tejkalimi i planit për të hyra vetanake përfshinë vlerën e mbledhur mbi planin buxhetor për vitin 2022 në vlerë prej 1,064,302.30 €, si dhe mjetet nga gjobat e trafikut, gjobat e gjykatave dhe gjobat pyjore për vitin 2022 në vlerë prej 3,087,224.55 €, në total mjetet për tejkalim të hyrave vetanake për vitin 2022 janë 4,151,526.85 €,

Dedikimi i këtyre mjeteve sipas kategorive do të jetë,

- Kategoria e pagave dhe shtesave, duke u bazuar në lëndët me vendim nga gjykata për kthimin dhe kompensimin e zyrtarëve të larguar nga puna, obligime të parapara në vlerë prej 100,000.00 €,
- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, janë obligime ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, janë për konkurse ndërkombëtare për projekte ideore/zbatuese , për bashkëfinancime me partnerët e jashtëm për projekte, obligime në vlerë prej 4,980,000.00 €,
- Kategoria e subvencioneve dhe transfereve, obligimet e mbetura ndaj operatorëve për subvencionimet e bujqësisë për zhvillimin rural, subvencionimin e mbetur të projekteve të Kulturës, subvencionimin për ngrohje të qytetit, të gjitha obligimet janë në vlerë prej 250,000.00 €,
- Kategoria e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, si dhe projekteve të cilat janë në procedura, obligime në vlerë prej 46,095,219.16 €,

Të bashkëngjitura janë në forma tabelare.